

Nr. 2480 Prod.
Dj. 06.07.2017



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT
FIER

Nr. 493/3 Prot.

Fier me: 26/07/2017

LENDË: Kthim pergjigje per ligjshmerine e vendimeve te Keshillit te Bashkise Roskovec

DREJTUAR: Zj. Majlinda Bufi
Kryetare e Bashkise Roskovec

Roskovec

Bazuar ne Ligjin nr.107/2016 "Per Prefektin e Qarkut " neni 16 shqyrtaam vendimet e Keshillit te Bashkise Roskovec te marra ne mbledhjen e dates 22.05.2017.

Vendimi nr.40 date 22.05.2017- "Per nje ndryshim ne Vendimin nr.19 date 20.02.2017 " Per miratimin e listes paraprake te inventarit te pronave te palujtshme shtetore,te cilat jane ne territorin e njesise administrative Strum , Bashia Roskovec ,Qarku Fier." *eshte ne perputhje me ligjin* 139/2015 " Per vetqeverisjen vendore" dhe ne zbatim te ligjit nr.8743 date 31.07.2000 " Per Pronat e Palujtshme te Shtetit ", i ndryshuar dhe aktet nen ligjore ne zbatim te tij..

Vendimi nr.41 date 22.05.2017- "Per miratimin e listes se perdoruesve faktik te tokes bujqesore dhe subjektet perfitues te cilet plotesojne kushtet ligjore per t'i pajisur me AMTP ,vendndodhjen e tokes ,siperfaqen dhe kufitarete per cdo ngaster " *eshte ne perputhje me ligjin* 139/2015 " Per vetqeverisjen vendore" dhe ne zbatim te Ligjit Nr.9948 date 7.7.2008 " Per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore" I ndryshuar dhe VKM nr. 253 date 06.03.2013 " Per percaktimin e procedurave te plotesimit te akteve te marrjes se tokes bujqesorene pronesi te familjeve bujqesore te ish - kooperatives bujqesore " I ndryshuar.

Vendimi nr.42 date 22.05.2017- " Rikonstruksioni I rruges ish furri I bukes - Dylanjaket - Unaza e Re - rruga e Kurjanit " *eshte ne perputhje me ligjin* 139/2015 " Per vetqeverisjen vendore".

Vendimi nr.43 date 22.05.2017- " Per miratim fondesh dhe ndryshime ne Buxhetin e Bashkise per vitin 2017 " *eshte ne perputhje me ligjin* 139/2015 " Per vetqeverisjen vendore" dhe ne zbatim te Ligjit Nr.9936 date 26.06.2008 " Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH ".

Vendimi nr.44 date 22.05.2017- "Per dhenien e ndihmes financiare pronareve te demtuar ,nga demet e shkaktuara nga fatkeqesi natyrore, ne bashkine Roskovec " nuk mund te trajtohet sipas dispozitave te VKM 329 date 16.05.2012 " Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtria njerezore " *pasi ne rastin konkret nuk jemi ne rastin e paragrafit II " Shpalljen e gjendjes se jashte zakonshme ". Vendimi te rishikohet.*

PREFEKTI
Në Mungesë
Maksim G. OGA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 60 . DATË 22.05 . 2017

**PER NJE NDRYSHIM TE VENDIMIT NR.19 DATE 20.02.2017
“PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT JANË NË TERRITORIN E NJËSISË
ADMINISTRATIVE STRUM, NËN JURIDIKSIONIN E BASHKISË ROSKOVEC, TË
QARKUT TË FIERIT”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit Nr.8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, Keshilli i Bashkisë :

VENDOSI :

1. Miratimin e listës paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të ndodhura në territorin e Njesisë Administrative Strum, nën juridiksionin e Bashkisë Roskovec, të Qarkut të Fierit.
2. Lista e inventarit ka një numër total prej 33 (tridhjetë e tre) fletë dhe fillon me nr. rendor 1 (një) dhe përfundon me numrin rendor 162 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy).

K R Y E T A R

Eleni GOGA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 44. DATË 22.05. 2017

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRDORUESVE FAKTIK TË TOKËS BUJQËSORE DHE
SUBJEKTET PËRFITUES TË CILËT PLOTËSOJNË KUSHTET LIGJORE PËR T’I PAJISUR ME
AMTP, VENDNDODHJEN E TOKES, SIPËRFAQEN DHE KUFITARËT PËR CDO NGASTER”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligj nr. 62/2016 datë 2.6.2016. Për disa ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë” VKM nr. 338 datë 22.04.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.253 datë 06.03.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatra të ish-kooperativave bujqësore”, Keshilli i Bashkise,

VENDOSI:

Miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore, listën e subjekteve përfitues, të cilët plotësojnë kushtet ligjore për t’i pajisur me AMTP si edhe sipërfaqen e përgjithshme të tokës bujqësore për çdo subjekt përfitues, të detajuar edhe sipas ngastrave, si dhe kufitarët për çdo ngastër, të ndarë keto për Njësite Administrative Kurjan dhe Strum si me poshte:

**Te dhenat per ngastrat, nr. I pasurise, zona kadastrale dhe sip. e aplikantit per tu pajisur me AMTP
Nj.A.Kurjan**

Nr.	Emer Mbiemeri	Z. K.	Nr. Pasurise	Sip. qe ka aplikuar ne m2	Sip. qe perfiton ne m2	Kufitare			
						Veri	Lindje	Jug	Perendim
1	Behar Jashari	2336	126/6	6437	6437	Kanal	126/5	kanal	126/7

Te dhenat per ngastrat, nr. I pasurise, zona kadastrale dhe sip. e aplikantit per tu pajisur me AMTP
Nj.A.Strum

Nr.	Emer Mbiemer	Z. K.	Nr. Pasurise	Sip. qe ka aplikuar ne m2	Sip. qe perfiton ne m2 gjithsej	Kufitare					
						Veri	Lindje	Jug	Perendim		
1	Lulezana Hajdar Musko	3532	36/12	540	8550	Rruge	36/13	36/17	36/10		
			16/6	8000				16/6 B	rruge		
2	Hamite Myslim Musko (Ali Muharrem Musko)	3532	16/11 A	1000	5225	16/11	rruge	16/12	kanal		
			36/9	4425				Rruge	36/11	kanal	36/8
3	Azbie Sadush Cjapi (Sadush Haxhi Hazizi)	3532	8//5	6500	12400	8//4	rruge	8//6	kanal		
			6//3	6100				6//2	rruge	04-Jun	kanal
4	Irfan Ruko	3532	59/30	2180	8550	B. Ruko	K. Ruko	A. Ruko	I. Toska		
			72/51	2588				I. Toska	B. Ruko		
			48/10/C	2000				K. Ruko	kanal		
			40/24/C	2000				Kanal	K. Ruko	Rruge	Xh. Xhafa
5	Kasem Ruko	3532	59/31	2400	8555	D. Ruko	D. Ruko	I. Toska	I. Ruko		
			40/24/B	2000				Kanal	D. Ruko	Rruge	I. Ruko
			48/10/B	2000				D. Ruko	kanal	I. Ruko	kanal
			72/52	2570				I. Toska	I. Ruko	R. Cjapi	I. Ruko
6	Drita Sami Ruko	3532	72/53	2568	8300	I. Toska	N. Strumi	K. Cjapi	K. Ruko		
			40/24/A	2000				Kanal	40/25	Rruge	K. Ruko
			59/32	4150				R. Cjapi	rruge	I. Toska	K. Ruko
			48/10/A	2000				B. Ruko	kanal	K. Ruko	kanal
7	Luto Refat Hazizi	3532	119/4/A	3700	3700	119/3	kanal	119/5	rruge		
8	Sulo Refat Xhoka	3532	53/8/A	2737	5700	53/9	53/16	53/7	Rruge		
			54/4/A	1850				Rruge	54/5	Kanal	54/3
			108/17/A	2400				108/16	Kanal	Kanal	Rruge
9	Baftjar Rustemi	1030	24/6	4000	12300	Rruge	170	23/2	24		
		1030	21/9	6000				21/8	Kanal	21/10	Rruge
		1030	23/10	3000				Rruge	23/11	Kanal	23/9
10	Fatmir Ruko	3532	72/8	4200	17100	72/9	72/10	72/5	72/7		
			120/9	2800				Rrugë	120/10	Rrugë	120/7
			70/14	2300				Kanal	70/15	Rrugë	70/13
			16/3	8000							
11	Agim Musko	3532	36/10	1000	11200	Rrugë	36/12	36/11	36/9		
			16/11	11000				16/10	Kanal	16/12	Rruge

12	Demir Sakaj	3532	72/96-A	2880	8580	72/95/B	72/104	72/9	72/88
		3532	117/10	5700		117/9	rruge	117/11	kanal
13	Feçorr Rroko	3235	51/5	9000	19400	Kanal	51/6	Rruge	51/4
		3235	53/14	1250		53/13	rruge	53/15	53/11
			54/3	3500		rruge	54/4	Rruge	54/1
			53/15	5850		rruge	rruge	53/17	53/16
14	Jonuz Hazizi	3532	6/6	6700	6700	6/4	rruge	6/7	kanal
15	Ferit Kocaqi	3538	A	28000	28000				
16	Asqeri Kocaqi	3532	A	1000	8600				
			145/17	730		145/15	rruge	H.Kocaqi	145/16
			116/1/A	5600					
			79/68	1270		79/66	79/73	79/75	79/67
17	Myertezan Sakaj	3532	117/8	5600	8550	117/7	Rruge	117/9	Rruge
			72/6/A	2800		72/15	72/7	72/6/B	kanal
			72/95/B	2800		72/106	72/105	72/95/A	72/90
18	Agron Hazizi	3532	108/8/A	5700	8550	108/8/13	Rruge	108/9	kanal
			104/2	800		Rruge	104/3	rruge	104/1
			77/4	2625		Rruge	Kanal	kanal	Rruge
19	Shaban Sakaj	3532	72/95-C	2800	11140	72/90	72/105	72/95	72/90
			117/9	7340		117/8	Rruge	117/10	kanal
			72/6-B	1000		Rruge	72/7	72/5	Rruge

KRYETAR

Eleni GOGA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 42. DATË 22.05.2017

*** RIKONSTRUKSION I RRUGES ISH FURRI I BUKES – DYLANJAKET – UNAZA E RE -
RRUGA E KURJANIT***

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar; të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, Keshilli i Bashkisë:

VENDOSI

Miratimin e projektit për rikonstruksionin e rrugës “Ish Furri i Bukes – Dylanjaket – Unaza e Re – Rruga e Kurjanit”. Sistemimi i rrugës me çakëll dhe stabilizant, në gjerësinë 4m do t’u mundësojë banorëve, që jo vetëm të lëvizin më lirshëm e më të sigurt, por dhe të kenë një ambient më të pastër. Rruga është në një gjendje të atillë që vështirëson kalimin e mjeteve. Është e pashtuar pa kanalizime të ujrave. Gjatësia e kësaj rruge është 1.1 km.

Realizimi i këtij projekti do të mundësojë një lidhje më të shpejtë, midis hapësirave urbane, të qytetit të Roskovecit. Në degën nr.2 të projektit, parashikohet ndërtimi i një ure Auto Hd=2m, B=5m dhe H=2m. Gjithashtu në shumicën e gjatësisë së rrugës, projekti parashikon ndërtimin e një kanali kullues, për kullimin e ujërave. Në këtë mënyrë ndikon në ekonominë e zonës duke lehtësuar transportin e produkteve bujqësore dhe e prodhimeve të fermerëve.

- 1- Vlera totale e projektit: 7 422 374 lekë me TVSH
- 2- Burimi i financimit :Buxheti i Bashkise per vitin 2017,fondi nga zeri “Materiale”

KRYETAR

Eleni GOGA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI I BASHKISE

V E N D I M

NR 63 .DATE 22 . 05 .2017

"PER MIRATIM FONDESH DHE NDRYSHIME NE BUXHETIN E BASHKISE PER VITIN 2017"


Ne mbeshtetje te ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne RSH",ligjit nr. 130/2016 date 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017",Udhezimi nr.2 date 6.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", i ndryshuar,i VKB nr. 80 date 21.12.2016 "Per miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal te bashkise Roskovec per vitin 2017", te shkreses nr.5862 prot. date 27.04.2017 te Ministrise se Finances "Dergohet fondi i rritjes se pagave per funksionet e trasferuara" , si dhe propozimeve dhe kerkesave nga NJA Kuman dhe Shkolla e Mesme Roskovec,keshilli I bashkise;

V E N D O S I:

- I. Të miratojë detajimin e fondit ne shumen 1,471,470 (Grant specific shtese per vitin 2017 per funksionet e trasferuara) te akorduar per perballimin e efektit te rritjes se pagave si me poshte vijon:
 1. Programi Arsimi parashkollore (Gr.00 Tit.09120 Kap.1)
Paga (Art.600) - 900,000 leke
Sig.shoqerore (Art.601) – 130,344 leke
 2. Programi Arsimi parauniversitar (Gr.00 Tit.09230 Kap.1)
Paga (Art.600) -200,000 leke
Sig.shoqerore (Art.601) -52,072 leke
 3. Programi Ujitja dhe kullimi (Gr.00 Tit.04240 Kap.1)
Paga (Art.600) -160,000 leke
Sig.shoqerore (Art.601) -29,054 leke
- II. Te miratoi fondin prej 78,000 leke per dhenien e ndihmes per familjen e znj. Qivie Rapi nga fshati Luar i NJA Kuman, per perballimin e shpenzimeve te varrimit per Lefteri Rapi per shkak te gjendjes se veshtire ekonomike te kesaj familje .
Fondi te përballohet nga fondi rezerve 2017.
- III. Te miratoi efektin financiar prej 30.000 leke per perballimin e shpenzimeve te transportit per 8 femije jetim nxenes te klasave te X dhe XI ne shkollen e mesme Roskovec sipas listes se paraqitur nga Drejtoresha e shkolles .
Fondi te përballohet nga fondi rezerve 2017.

K R Y E T A R

Eleni GOGA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR.44 DATE 22.05.2017

**“PER
DHENIEN E NDIHMES FINANCIARE PRONAREVE TE DEMTUAR, NGA DEMET E
SHKAKTUARA NGA FATKEQESI NATYRORE, NE BASHKINE ROSKOVEC”**

Ne mbeshtetje te ligjit nr.139/2015 “Per Vetqeverisjen Vendore”, te Ligjit nr.8756 date 26.03.2001 “Per Emergjencat Civile”, te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.329 date 16.05.2012 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore”, paragrafi III, pika 1, germa ë, Keshilli i Bashkise,

VENDOSI:

1. Dhenien e ndihmes financiare pronareve, tokat bujqesore te te cileve jane demtuar nga demet e shkaktuara nga fatkeqesi natyrore, konkretisht nga bresheri i rrembyeshem dhe kokerrmadh qe ka rene me date 17.05.2017 ora 19:45 – 20:20 ne territorin e Bashkise Roskovec, Njesise Administrative Kurjan dhe Njesise Administrative Kuman.
2. Grupet e punes te ngritur me urdher te brendshem te kryetares se Bashkise, pas verifikimeve dhe vleresimeve kane evidentuar pronaret, tokat bujqesore te te cileve jane prekur nga keto deme.
3. Duke qene se Bashkia Roskovec ndodhet ne pamundesi financiare per te demshperblyer keta banore te demtuar kerkohet miratimi per dergimin e ketij vendimi Drejtorise se Bujqesise Fier dhe Ministrise se Bujqesise, per zbatim.
4. Bashkengjitur:
 - Lista emerore e pronareve te demtuar,
 - Te dhena per kulturat bujqesore te demtuara.

KRYETAR
Eleni GOGA